



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008 dhe të nenit 36, paragrafi 36.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/15, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

th ë r r e t

mbledhjen e **katërt** të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më **25.07.2017**, dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. “UÇK”, nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

Rend dite:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe mbledhjes urgjente të Kuvendit të Komunës;
2. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë ndërmarrjes publike komunale “Hortikultura”;
3. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit “Vier Pfoten”;
4. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike (parcela 285-0);
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë;
6. Propozimvendimi për bashkimin e blloqeve F-6, F-16, F-17 në kuadër të Planit rregullues urban “Prishtina e re – Perëndim”;
7. Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të bllokut “C-5”, në kuadër të Planit rregullues urban “Medrese – Çamëri”;
8. Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të parcelës 494-4, në kuadër të Planit rregullues urban “Prishtina e re – Perëndim”;
9. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike (afatshkurtër);

Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://eee.prishtina-komuna.org>

10. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës;
11. Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme;
12. Raporti për sigurinë në shkolla;
13. Njoftim lidhur me xhaminë e re në lokacionin afër postës në Prishtinë;
14. Pyetje dhe përgjigje;
15. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-060/01-0171262/17, më 14.07.2017

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
Halim Halimi, jur. i dipl.



Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://eeë.prishtina-komuna.org>